

KONTRATE
PER THEMELIMIN E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“T.M.I. TECNOLOGIA MODA ITALIA” SHPK

Ne Durres, sot me date 25 Janar 2018, ne ortaket themelues:

1. Shoqeria “Missardi” s.p.a., shoqeri e se drejtes italiane, me seli ne Itali, Empoli (FI), Via Vittime del Fascismo 9, cap.50053, regjistruar ne regjistrin e ndermarrjeve te Dhomes se Tregtise, Industrise, Artizanatit dhe Bujqesise ne Firenze, me numer repertori ekonomik administrativ FI-619648, me kod fiskal 01117240471, perfaqesuar sipas Vendimit te Keshillit te Administrimit te Shoqerise, nga zoti Massimo Calugi, atesia Sabatino, lindur ne Lamporecchio (PT), me 06.04.1958, banues ne Itali, Montecatini Terme (PT), Via Vincenzo Bellini n.20 int.2, shtetas italian, mbajtes i kartes italiane te identitetit nr.AV5758909, leshuar me 19.11.2014, madhor, me zotesi te plote juridike e per te vepruar;

2.Roberto BASILE, atesia Giuseppe, lindur me 22.07.1964, ne Livorno (LI) dhe banues ne Itali, Pistoia (PT), Via Antonelli Padre Giovanni nr.15, shtetas italian, mbajtes i Kartes italiane te identitetit nr.AT 1051736, leshuar me 17.06.2013, madhor, me zotesi te plote juridike e per te vepruar;

3.Sergio ROMANO, atesia Luigi, lindur me 09.02.1972, ne Napoli dhe banues ne Shqiperi, Durres, L.13, Plazh, shtetas italian, mbajtes i Kartes italiane te identitetit nr.AV 9239481, leshuar me 14.06.2015, madhor, me zotesi te plote juridike e per te vepruar; me vullnetin tone te lire e te plote, kemi vendosur si me poshte vijon:

Neni 1

Emri, forma, selia e shoqerise

Te themelojme shoqerine me pergjegjesi te kufizuar me emrin:

“T.M.I. Tecnologia Moda Italia” Shpk, (qe ketu e me poshte do te quhet shoqeria), me seli ne Shqiperi, Durres, Lagja nr.14, Shkozet, zona kadastrale 8516, nr.pasurise 20/65.

Neni 2

Shoqeria "T.M.I. Tecnologia Moda Italia" Shpk është person juridik shqiptar dhe fiton personalitet juridik që nga dita e regjistrimit në Regjistrin Tregtar pranë Qendres Kombetare të Biznesit.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas neneve të kësaj kontrate, statutit bashkangjitur, Ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar,

Ligjit nr.9723 date 03.05.2007 "Për Qendrën Kombetare të Regjistrimit" si dhe legjislacionit tjetër shqiptar.

Neni 3

Kohezgjatja e shoqërisë

Kjo shoqëri do ta ushtrojë aktivitetin e saj për një periudhë kohe të pacaktuar.

Neni 4

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë

Shoqëria ka si objekt veprimtaritë e mëposhtme:

*Hapje linje rrobaqepsie, më vete dhe/ose fason, konfeksione me lende të para, material porositesi, metrazhe, pelhure, lekure, peliceri, prodhim kepucesh, çanta, rroba pune, prodhim dhe tregtim me shumice dhe pakice, me anë të importit dhe eksportit, i rrobave dhe konfeksioneve të shumëllojshme, të stileve dhe modeleve klasike, sportive dhe të brendshme, trikotazheve, lekure, inkelit, parfume, kozmetike, si edhe me të gjitha llojet e metrazheve (stofra), transportin e tyre brenda dhe jashtë vendit. Shoqëria mund të veprojë në sektorin e pasurive të paluajtshme, akomodimit turistik, ushqimor, të lundrimit dhe të hotelerisë.

*Shoqëria gjithashtu mund të zhvillojë çdo aktivitet tjetër të konsideruar të nevojshëm ose të domosdoshëm për përmbushjen e objektit të shoqërisë.

Neni 5

Kapitali i regjistruar dhe struktura e tij

Kapitali i regjistruar i shoqërisë përbehet vetëm nga kontribute në para dhe është në shumën 1000 Lek (njemije), *i cili është nënshkruar plotësisht, por nuk është paguar.*

Ky kapital eshte i ndare ne 3(tre) kuota. Pjesemarrja e ortakeve themelues ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tyre te meposhtme:

1.Ortaku themelues "Missardi" s.p.a., zoteron nje kuote te vetme:

lloji i kontributit: ne para; vlere e kontributit 600 Lek (gjashteqind), i cili eshte nenshkruar plotesisht, por nuk eshte paguar;

zoterimi i tij ne kapitalin e shoqerise eshte ne masen 60 %;

2.Ortaku themelues Roberto Basile, zoteron nje kuote te vetme:

lloji i kontributit: ne para; vlere e kontributit 200 Lek (dyqind), i cili eshte nenshkruar plotesisht, por nuk eshte paguar;

zoterimi i tij ne kapitalin e shoqerise eshte ne masen 20 %;

3.Ortaku themelues Sergio Romano, zoteron nje kuote te vetme:

lloji i kontributit: ne para; vlere e kontributit 200 Lek (dyqind), i cili eshte nenshkruar plotesisht, por nuk eshte paguar;

zoterimi i tij ne kapitalin e shoqerise eshte ne masen 20 %;

Neni 6

Administrator i vetem i shoqerise per nje periudhe kohe 5(pese) vjeçare, me mundesine e i riemerimit nga asambleja e ortakeve, do te jete:

Klotild ALINJ, atesia Vladimir, lindur ne Tirane, me 18.11.1978, me numer personal H81118039T, banues ne Shqiperi, Durres, L.3,Rr.Egnatia, shtetas shqiptar, mbajtes i Leternjoftimit shqiptar nr.026030364, leshuar me 01.06.2009.

Ne funksion te aktivitetit qe kryen, shoqeria ka te drejte te caktojte edhe administratore te tjere qe mund te jene persona fizik shqiptar apo te huaj. Administratore mund te emerohen edhe personat qe nuk jane ortake te shoqerise. Ata mund te jene te riemerueshem nga asambleja e ortakeve qe vendos me vote te favorshme te atyre ortakeve qe perfaqesojne te pakten gjysmen e kapitalit te regjistruar te shoqerise.

Neni 7

Shoqeria ka te drejte te kete llogari ne leke dhe valute, ne bankat shqiptare dhe ne ato te huaja, ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe ka te drejte te disponoje lirshem mjetet monetare te mbledhura.

Neni 8

Shoqeria me vendim te asamblese se ortakeve, te marre me vote te favorshme te atyre ortakeve qe perfaqesojne te pakten gjysmen e kapitalit te regjistruar te shoqerise, ka te drejte te hape dege dhe/ose zyra te perfaqesimit, te jete meme apo shoqeri e kontrolluar ne perputhje me legjislacionin tregtar dhe ate shqiptar ne pergjithesi.

Neni 9

Ortaket jane te detyruar te ruajne sekretin tregtar.

Neni 10

Çeshtjet e kapitalit dhe te kuotave te tij, kalimi i kuotave, menyra e administrimit te shoqerise dhe çeshtje te tjera, do te percaktohen me hollesi ne Statutin e shoqerise.

Neni 11

Kjo Kontrate Themelimi eshte hartuar ne tete origjinale, kater ne gjuhen shqipe dhe kater ne gjuhen italiane. Ne rast mosperputhje ndermjet dy gjuheve, versioni ne gjuhen shqipe do te mbizoteroje.

Ortaket themelues te "T.M.I. Tecnologia Moda Italia" Shpk

1. Shoqeria "Missardi" s.p.a

2. Roberto Basile

3. Sergio Romano

Perfaqesuar nga Massimo Calugi



Perkthyes ligjor

IRIS DHAMO
JED
